



Emër Mbiemër: **KRISTINA JORGAQI JANO**
Datëlindja: **1962**
Vendlindja: **Tiranë**

Viti i zgjedhjes: **2020 (Akademike e asociuar)**
Seksioni: **Shkencat shoqërore dhe albanologjike**
Gjuhët: **Anglisht, italisht, frëngjisht**

Kontakt

Adresa:

Telefon:

E-mail: **kristina.jorgaqi@fhf.edu.al**

Faqe zyrtare: **www.fhf-ut.edu.al; www.akad.gov.al**

CV e shkurtër

Studiuese në fushën e gjuhësisë, pedagoge, përkthyesë, veprimtare e shoqërisë civile, e para gjuhëtare anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kreu me rezultate të shkëlqyera studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (1981-1985). Zhvilloi veprimtarinë e saj kërkimore fillimisht pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave (1985-2010) dhe më pas në Departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Historisë e Filologjisë të Universitetit të Tiranës (2010 - sot). Fitoi gradën *Doktore e Shkencave Filologjike* (PHD) (1996) dhe më vonë titujt *Profesore e asociuar* (2002), *Profesore* (2010) dhe *Akademike e asociuar* (2020).

Një pjesë e rëndësishme e kontributit të saj shkencor i takon fushës së **gjuhësisë së kontakteve** (*Contact Linguistics*), në kuadrin e së cilës është marrë me *marrëdhëniet mes shqipes dhe italishtes*, e posaçërisht me ndikimin italian mbi shqipen (një prej ndikimeve më të hershme e njëherësh më të pasura, më të qëndrueshme e të pandërprera përgjatë 10 shekujve të fundit). Jorgaqi e ka studjuar ndikimin italian mbi shqipen në një rrafsh shumë të gjerë, që përfshin gjuhën e autorëve të monumenteve të shkrimit shqip (Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani) dhe shqipen moderne, parë kjo e fundit edhe në rrafsh krahasues ballkanik. Përmes këtyre studimeve ajo ka kontribuar për njohjen më të mirë të leksikut historik të huazuar të shqipes së shkruar dhe ndriçimin e mëtejshëm të strukturës etimologjike të saj, përcaktimin e vendit që huazimet italiane zënë në leksikun e shqipes moderne si dhe të fushave, ku ato mbizotërojnë, qartësimin e disa çështjeve lidhur me italianizmat leksikore të shqipes nga këndvështrimi i gjuhësisë ballkanike etj.

Jorgaqi ka dhënë gjithashtu kontributin e saj kërkimor-shkencor në fushën e **planifikimit gjuhësor** (*Language Planning*) duke hetuar e studjuar nga këndvështrimi i kësaj disipline mendimin gjuhësor të Faik Konicës, veprimtarinë e Komisionit Letrarez Shqipe (1916-1918), veprimtarinë “purifikuese” leksikore të zhvilluar në kuadër institucional përgjatë viteve '80 të shekullit të kaluar, çështje të drejtshkrimit të shqipes etj.

Interesat kërkimore të Jorgaqit i takojnë edhe dy fushave të tjera studimesh, siç janë **leksikografia tekstuale** dhe ajo **historike**, në kuadër të të cilave ajo “ka inventarizuar” e studjuar leksikun e veprës së njërit prej përfaqësuesve më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e të kulturës shqiptare në përgjithësi, Faik Konicës.

Jorgaqi ka ndihmesë të veçantë në kultivimin dhe përhapjen e një zhanri si ai i shkrimeve shkencore-divulguese, pjesë e rubrikave gjuhësore të mbajtura prej saj në median e shkruar e të folur (Radio BBC), të vetmet e këtij lloji përgjatë tre dekadave pas ndryshimit të sistemit politik në Shqipëri.

Kontributet e Jorgaqit gjenden në 6 libra të botuar brenda vendit, 20 artikuj të botuar në periodikë shkencorë shqiptarë e të huaj të fushës së gjuhësisë (*Studime filologjike, Studime albanologjike, Studia albanica, Zeitschrift für Balkanologie, Studi di lessicografia italiana* etj.), në rreth 100 shkrime shkencore-divulguese, artikuj e intervista të botuara në shtypin shqiptar, në 10 referime shkencore në veprimtari shkencore ndërkombëtare (*Kongresi VII e VIII i Studimeve të Europës Juglindore - AISEE* etj.).

Jorgaqi është titullare e lëndëve *Sociolinguistikë* dhe *Planifikim gjuhësor*, hartuese e programeve dhe e cikleve të leksioneve përkatëse. Ajo ka mbajtur gjithashtu kurse leksionesh në lëndët *Gjuhësi ballkanike, Metodologji e punës shkencore në gjuhësi dhe Etnolinguistikë*. Me propozimin e saj *Planifikimi gjuhësor* u përfshi për herë të parë si lëndë në programet mësimore të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë.

Ajo ka zhvilluar veprimtari hulumtuese pranë disa institucioneve kërkimore-shkencore e arsimore të huaja, si *Accademia della Crusca, Università degli Studi di*

Napoli Federico II e Università degli Studi di Cosenza, si dhe ka mbajtur leksione në Fakultetin e Gjuhës Polake e të Filologjisë Klasike të Universitetit Adam Mickiewicz, Poznan, Poloni.

Jorgaçi është anëtare e 2 bordeve botuese, 1 redaksie shkencore, 1 komiteti ministror dhe kryetare bordi e 1 shoqate jofitimprurëse (YWCA of Albania). Jorgaçi është pjesëmarrëse në 2 projekte ndërkombëtare dhe 1 projekt kombëtar.

Publikime (monografi, studime, vepra të ndryshme të botuara)

- 2020** *Fjalor i shqipes së Faik Konicës*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 425 fq.
- 2011** *Konkordancë e lematizuar e shkrimeve të Faik Konicës në revistën ALBANIA (1897-1909)* (në format elektronik).
- 2008** *Sportel i hapur i shqipes*, Tiranë, Ombra GVG, 354 fq.
- 2007** *Faik Konica, Mendime gjuhësie*, Tiranë, Ombra GVG, 312 fq.
- 2003** *Thërrmija gjuhësore*, Tiranë, Botimet Ora, 137 fq.
- 2001** *Ndikimi italian në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Tiranë, Botimet Toena, 312 fq.
- 2000** *Leksione xhepi për gjuhën*, Tiranë, Shtëpia botuese Dituria, 112 fq. (bot. II, Tiranë, Botimet Dudaj, 2001, 152 fq.)